


PRISHTINË, SHKURT 2020

INTEGRITETI AKADEMIK DHE PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E PEJËS



INTEGRITETI
AKADEMIK
DHE PUBLIKIMI
SHKENCOR NË
UNIVERSITETIN
E PEJËS

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

Hulumtuese:

Saranda Sylejmani

Autorë:

Saranda Sylejmani

Skord Retkoceri



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajë mbi të! Frymëzona me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

Shkurtesat dhe definicionet.....	7
Hyrje.....	8
Të dhënat e përgjithshme	9
Fakulteti i Agrobiznesit.....	12
Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm Hotelieri dhe Mjedis (MTHM)	15
Fakulteti i Biznesit.....	17
Fakulteti Juridik	20
Metodologjia e hulumtimit të punimeve shkencore	21
Metodologjia e hulumtimit të justifikimit të titujve	24

DEFINIME

Punime me koeficient - konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat në fuqi

Punime në revista të dyshimta - punimet të cilat janë të listuara në listën Beall

Justifikimi i titullit - të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi

Burra dhe gra - Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal

HYRJE

Nevoja e publikut për të ditur për cilësinë e universiteteve publike të cilat pjesën dërrmuese të fondeve e marrin nga paratë e taksapaguesve, bëri që ORCA të fillojë hulumtimet e ngjashme me ato që janë zhvilluar për 3 vjet të plota në Universitetin e Prishtinës, në të gjitha universitetet tjera publike.

Ky raport vjen si rezultat i punës hulumtuese të bërë gjatë periudhës qershor – tetor 2019 ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e paraqitura në CV-të e stafit akademik të Universitetit të Pejës me tituj profesorialë: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Siç mund të ishte e pritshme, rezultati nuk është i kënaqshëm, por një analizë e tillë mund të jetë e dobishme për ta planifikuar reformën e ardhshme apo edhe për të marrë ndonjë veprim tjetër si masë për sanimin e situatës.


Numri i vogël i punimeve shkencore të publikuara në revista të mirëfillta nga profesorët si autor i parë ose korrespondent, ndërkaq shumëfishi i tij në revista të dyshimta, është tregues se presioni për publikim në njëri anë e mosfinancimi i projekteve shkencore në anën tjetër, kanë bërë që shumica e profesorëve të shtyhen derjt situatës ku publikojnë sa për të publikuar. Kjo ka prodhuar një realitet ku publikimi në revista të dyshimta është bërë fenomen e jo përjashtim siç mund të merrej me mend.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

PUBLIKIMI SHKENCOR


Që nga 2006 e deri në 2018 profesorët e Universitetit të Pejës kanë publikuar në total 23 punime me koeficient, si autorë të parë ose korrespondent. 22 profesorë nuk kanë asnjë punim me koeficient. Numri më i lartë i profesorëve me 0 punime është në Fakultetin e Agrobiznesit dhe Fakultetin e Biznesit me nga 8 profesorë secili.

PUNIMET NË REVISTA ME KOEFICIENT



Në vitin 2008 dhe 2010 vërehet se nuk është publikuar asnjë punim kurse nga 2013-ta shihet një ngritje e numrit të punimeve. Numri i përgjithshëm i punimeve në revista të dyshimta është 84. Nëse krahasohet me numrin e punimeve me koeficient atëherë i bie që numri i punimeve në revista të dyshimta është 3.65 herë më i lartë.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



ANEKS 1. TABELA E PUNIMEVE NË REVISTA SIPAS FAKULTETEVE

Tabela e punimeve në revista shkencore sipas fakulteteve

Nr.	Fakulteti	Punimet në re- vista shkencore - autor i parë apo korrespondent	Punime në revista të dyshimta	Numri i pro- fesorëve	Punime/ profesor
1	Fakulteti i Agrobiznesit	12	33	11	1
2	Fakulteti MTHM	2	29	6	0.3
3	Fakulteti Juridik	5	1	5	1
4	Fakulteti I Biznesit	4	21	11	0.4
TOTAL		23	84	33	0.7

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Në Universitetin e Pejës janë evidentuar 33 profesorë nga të cilët 9 profesorë (30%) i justifikojnë titujt akademikë, ndërsa 24 profesorë (70%) nuk i justifikojnë titujt akademikë. Universiteti i Pejës numëron vetëm një profesor të rregullt, 12 profesorë të asocuar dhe 20 profesorë asistentë.

4 profesorë i justifikojnë titujt dhe kanë të botuar punime në revista të dyshimta. Kurse nga radhët e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt akademikë dhe kanë të botuar punime shkencore, bëjnë pjesë 11 persona. Në total 15 profesorë (45%) kanë punime të botuara në revista të dyshimta.

ANEKS 1. TABELA E TË DHËNAVE TË PËRGJITHSHME SIPAS FAKULTETEVE

No.	Fakultetet në Universitetin e Pejës	Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
		Prof. ass	Prof. asoc.	prof. rreg	Prof. ass	Prof. asoc.	prof. rreg
1	Fakulteti Agrobiznesit	1	0	1	7	2	0
2	Fakulteti MTHM	2	0	0	1	3	0
3	Fakulteti Juridik	2	1	0	1	1	0
4	Fakulteti Biznesit	2	0	0	4	5	0
TOTAL		7	1	1	13	11	0
		9			24		

FAKULTETI I AGROBIZNESIT




Gjithsej ky fakultet numëron **11 profesorë** të punësuar si staf i rregullt akademik, nga të cilët **10** janë burra dhe vetëm **1** është grua.

PUBLIKIMI SHKENCOR

Në fakultetin e Agrobiznesit në total janë publikuar 12 punime me koeficient nga profesorët si autor i parë ose korrespondent, përgjatë një periudhe 7 vjeçare - 2011 deri në 2018 - ku në vitin 2017 ka pasë më së shumti publikime kredibile gjithsej 3.

PUNIMET ME KOEFICIENT




PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

7 profesorë kanë botuar në revista të dyshimta, 2 prej të cilëve janë profesorë të asocuar dhe 5 janë profesorë asistentë. Asnjëri nga këta profesorë nuk i justifikojnë titujt akademikë.


Këta profesorë kanë publikuar gjithsejt 33 punime në revista të dyshimta për një interval kohor 12 vjeçar, ku më së shumti autorët e këtyre punimeve kanë botuar në vitin 2012.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



Një tjetër e gjetur e rëndësishme për këtë fakultet tregon se profesorët asistentë janë personat që më së shumti kanë publikuar në revista të dyshimta. 4 profesorë me këtë titull akademik janë burra dhe vetëm 1 është grua. Për më tepër, duhet theksuar se 2 profesorë të asocuar kanë botuar në revista të dyshimta.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nga 11 profesorë të këtij fakulteti vetëm 2 prej tyre i justifikojnë titujt akademik, kurse 9 profesorë janë jomeritorë. Profesorët që më së shumti nuk i justifikojnë titujt janë profesorët asistentë, mirëpo kjo kategori e profesorëve përbëjnë numrin më të lartë të të punësuarve si staf akademik.

Është e rëndësishme të theksohet se nga radhët e profesorëve që i justifikojnë titujt nuk ka punime të publikuara në revista të dyshimta, kurse prej atyre të cilët nuk i justifikojnë titujt janë publikuar 33 punime gjithsejt.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
1	0	1	7	2	0

FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM HOTELIERI DHE MJEDIS (MTHM)



MTHM i ka të punësuar **6 profesorë**, **4** prej të cilëve janë burra dhe **2 gra**. Burrat bartin tituj më të lartë akademikë në krahasim me gratë, ndonëse ky fakultet nuk ka asnjë profesor të rregullt. Kurse me titull profesor të asocuar janë në total **3 persona**, që të gjithë i takojnë gjinisë mashkullore.

PUBLIKIMI ME KOEFICIENT


Ky fakultet gjithsej i ka 2 punime me koeficient të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondent. Punimet janë nga profesorë që justifikojnë titujt akademikë dhe që të dy janë profesorë asistentë. Këto punime janë botuar në vitet 2015 dhe 2017

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Në total fakulteti i MTHM përgjatë viteve 2012-2017 ka publikuar 29 punime në revista të dyshimta. Viti 2015 shënon periudhën kur më së shumti janë publikuar punime të tilla, gjithsej 10.

Vetëm dy persona nga ky fakultet kanë punime të publikuara në revista të dyshimta dhe të dy rastet janë burra, njëri është me titull profesor asistent dhe tjetri profesor i asocuar.

BOTIMENË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 6 profesorëve vetëm 2 i justifikojnë titujt. Që të dy kanë titull akademik profesor asistent dhe vetëm njëri nga ta ka punime të botuara në revista të dyshimta me gjithsej 24 sosh. Kurse profesorët të cilët nuk i justifikojnë titujt akademikë janë 4. Prej tyre vetëm 1 profesor ka punime të publikuara në revista të dyshimta, gjithsej 5 punime.

Fakulteti i MTHM nuk ka të punësuar asnjë profesor të rregullt, 3 kanë gradë akademike profesorë të asocuar dhe që të gjithë janë burra kurse profesorë asistentë janë 3, dy nga të cilët janë gra. Asnjë grua nuk ka punime të publikuara në revista të dyshimta.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
2	0	0	1	3	0

FAKULTETI I BIZNESIT



Numri i përgjithshëm i stafit të rregullt akademik të evidentuar në këtë fakultet është **11**, nga të cilët **10** janë burra dhe vetëm **një grua**. Fakulteti i Biznesit nuk numëron asnjë profesor të rregullt. **5** janë profesorë të asocuar, që të gjithë burra dhe **6 profesorë asistentë** nga të cilët vetëm një grua.

PUBLIKIMI ME KOEFICIENT


Fakulteti i Biznesit ka gjithsej 4 punime të publikuara me koeficient nga profesorët si autorë të parë apo korrespondent. Këto punime janë botuar në vitet 2016, 2017 dhe 2018.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Në total 5 profesorë në Fakultetin e Biznesit kanë publikuar në revista të dyshimta, 3 nga të cilët nuk i justifikojnë titujt dhe 2 prej tyre i justifikojnë titujt akademikë.


Numri i punimeve të publikuara në revista të dyshimta për këtë fakultet është 21. Katër nga profesorët që kanë punime në revista të dyshimta janë burra nga të cilët njëri është profesor i asocuar, ndërsa 3 janë profesorë asistentë. Kurse personi tjetër që ka publikuar në revista të dyshimta është grua.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



Profesorët kanë përzgjedhur publikues të ndryshëm për t'i botuar punimet e tyre. Nga publikuesit më të shpeshtë vërehet të jetë MCSER. Gjatë hulumtimit është vërejtur se dy profesorë të këtij fakulteti kanë listuar në CV-të e tyre të njëjtin punim nga 2 dhe 4 herë si punime të ndryshme.

PUBLIKUESIT E REVISTAVE TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nga 11 profesorët e Fakultetit të Biznesit vetëm 2 i justifikojnë titujt, kurse 9 nuk i justifikojnë titujt. Fakulteti nuk ka asnjë profesor të rregullt mirëpo ka 5 profesorë të asocuar dhe asnjë prej tyre nuk e justifikon titullin akademik. Të gjithë janë burra.

Në total fakulteti numëron 6 profesorë asistentë, vetëm 2 nga të cilët i justifikojnë titujt. Nga kjo kategori e profesorëve është vetëm një grua, njëherit që justifikon titullin.

2 profesorë që i justifikojnë titujt kanë 4 punime në revista të dyshimta dhe 3 profesorë që nuk i justifikojnë titujt kanë 17 punime të botuara në revista të dyshimta.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
2	0	0	4	5	0

FAKULTETI JURIDIK



Numri i profesorëve të angazhuar me punë të rregullt në këtë fakultet vlerësohet si tejet i vogël, me gjithsej **5** të tillë, **3 burra** dhe **2 gra**. Nuk ka asnjë profesor të rregullt, ka **2 profesorë të asocuar** dhe **3 profesorë asistentë**. Sërish pozitat e larta akademike i kanë burrat pasi që të **dy profesorët** e asocuar janë burra. Nga profesorët asistentë **1** është burrë dhe **2** janë gra.

PUBLIKIMI ME KOEFICIENT

Fakulteti Juridik gjithsej ka 5 punime të publikuara me koeficient për një periudhë 11 vjeçare, nga viti 2007 deri në 2018.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Është identifikuar që vetëm 1 profesor ka publikuar 1 punim në një revistë të dyshimtë, që në herit mbanë titullin akademik profesor asistent.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nga 5 profesorë 3 i justifikojnë titujt, ndërkaq 2 nuk i justifikojnë titujt akademikë. 1 profesor që e justifikon titullin akademikë ka të publikuar 1 punim në revistë të dyshimtë

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
2	1	0	1	1	0

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË PUNIMEVE SHKENCORE

Baza Ligjore

- ① Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës
- ② Statuti i Universitetit të Pejës gjegjësisht Nenet 171, 172 dhe 173
- ③ Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension
- ④ Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin - (Aneksi -I MASHT) 07/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.
- ⑤ Rregullorja 754 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Pejës, “Haxhi Zeka”.

ORCA ka shqyrtuar një mori dokumentash relevante të implementuara nga organe të larta ligj vënëse në vend siç është Parlamenti i Kosovës dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Më kontretisht është analizuar ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, pastaj Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe UA 07/2018. E gjithë kjo manovër është realizuar me qëllim që hulumtimi të jetë sa më korrekt. Për më tepër, ORCA ka bërë analizimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare të përcaktuara si kriter nga Statusi i Universitetit të Pejës për zgjedhjen dhe emërimin e titujve akademikë si dhe Rregullorja 754 e Universitetit të Pejës. Me anë të këtyre kriterëve garantohej aktiviteti i vazhdueshëm shkencor që njëherit është esencial për përvetësimin e metodave dhe rezultateve bashëkohore, mbi të cilat garantohej mësimdhënia dhe kontributi i qëndrueshëm shkencor.

OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Për përpilimin e këtij raporti janë analizuar të dhënat e 4 fakulteteve të Universitetit të Pejës; ai i agrobiznesit, juridik, i biznesit dhe fakulteti i menaxhimit në turizëm hotelieri dhe mjedis. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Poashtu, ORCA nuk e ka bërë vlerësimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve, prandaj profesorët e këtij Fakultetit nuk janë përfshirë në raportin e ORCA-s.

PERIUDHA E Mbledhjes së të dhënave

Procesi i hulumtimit të CV-ve është realizuar gjatë muajit gusht të 2019-së në bazë të informatave të plasura në ueb-faqe. Kontrolla e fundit është bërë në tetor 2019. Hulumtimi është realizuar në bazë të shqyrtimit të të gjitha CV-ve të plasura në ueb-faqen e Universitetit të Pejës, <https://unhz.eu/>.

Me qëllim që hulumtimi të jetë sa më i saktë, CV u janë nënshtruar rishqyrtimit nga kolegji i ORCA-s. Të gjitha ndryshimet janë evidentuar gjatë takimit në kolegji ku prezent ishte i gjithë stafi i ORCA-s dhe rrjedhimisht të dhënat e analizës së hulumtimit janë azhurnuar në bazë të kritikave relevante.

SHQYRTIMET E REVISTAVE

Në bazë të legjislacionit së vendit për arsimin e lartë, më përkatësisht UA1/2018, UA7/2018 dhe Rregullores 754 të Universitetit “Haxhi Zeka”, ORCA ka vendosur koeficient për secilin punim. Koeficientet janë përcaktuar sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficient¹.

ORCA ka vlerësuar me koeficient 0 të gjitha punimet të cilat kanë qenë të publikuara në revista të dyshimta si dhe ato të cilat nuk janë të indeksuara në ndonjë prej 5 platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, siç përshkruhet tek UA 1/2018, neni 3.1

¹ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nder-kombetare-me-recension.pdf>

Vlen të theksohet fakti që punimet të cilat janë publikuara në revistat e dyshimta mirëpo në kohën kur janë publikuar ato kanë qenë të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, atëhere punimet e tilla janë vlerësuar si pozitive.

Për më tepër, ORCA ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilët nuk cilësohen si punime shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces e sipër të publikimit.

Punimet e publikuara në revista vendore janë përjashtuar nga vlerësimi pozitiv si dhe ato rajonale të cilat nuk janë të indeksuara në njërin nga platformat kredibile si Web of Science dhe Scopus.

Duke u bazuar në UA 7/2018, Neni 2, pika 4.2 2 që nënvizon se revista nga shkenca e albanologjisë mund të jetë vendore apo e Shqipërisë, nëse ka redaksi ndërkombëtare. Dhe vetëm në këtë rast është barasvlerësuar më koeficient 1 apo pozitiv.

SHQYRTIMI INDIVIDUAL DHE KOLEKTIV NGA HULUMTUESIT

Procesi i hulumtimit të të gjitha CV-ve është bërë nga një hulumtues i vetëm i ORCA-s. Me kujdes të shtuar, hulumtuesi ka verifikuar secilën CV dhe punim shkencor që është listuar në CV. E gjithë kjo për të verifikuar në rast se punimi është botuar në revistat e indeksuara nga 5 platformat me recension apo është botuar në njërin nga revistat e dyshimta që përkon të jetë në "Listën e Beall".

² https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE

Janë analizuar 33 CV të stafit të rregullt akademikë të Universitetit të Pejës, “Haxhi Zeka”. Procesit të analizimit ju janë nënshtruar 4 Fakultete me përjashtim të Fakultetit të Arteve pasiqë, ORCA nuk zotëron kapacitetet vlerësuese për shqyrtimin e veprave të artit me anë të së cilave profesorët avansohen. Si pasojë profesorët e Fakultetit të Arteve nuk janë pjesë e raportit të ORCA-s. Për më tepër, ky hulumtim anashkalon asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i gëzojnë titujt akademikë si profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Analizimi i CV-ve të stafit akademik është bërë në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore të Kosovës për arsimin e lartë. Më konkretisht shqyrtimi i CV-së është bërë ashtu siç përcaktohet në UA 1/2018, mbi revistat ndërkombëtare me recension dhe ligjeve përkatëse në fuqi. Është bazuar veçanërisht tek rregullorja e Universitetit të Pejës 754, mbi procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregulltë si dhe tek statusi i Universitetit të Pejës

Titulli akademik, Profesor i Rregullt³ ndër të tjera precizon se për këtë gradë akademike kandidati duhet të ketë doktoratën dhe të paktën 5 punime të publikuara në revista shkencore si autor i parë ose korrespondent.

Titulli akademik, Profesor i Asocuar⁴ ndër të tjera thotë se për këtë gradë akademike kandidati duhet të ketë doktoraturën dhe të paktën 3 punime të publikuara në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent.

Titulli akademik, Profesor Asistent⁵ ndër të tjera specifikon se për këtë gradë akademikë kandidati duhet të ketë doktoraturën dhe të paktën 1 punim të publikuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent.

3 Neni 171, pika 1.1 dhe 1.1.2, Statuti i Universitetit të Pejës

4 Neni 172, pika 1.1 dhe 1.2, Statuti i Universitetit të Pejës

5 Neni 173, pika 1.1 dhe 1.2, Statuti i Universitetit të Pejës

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencionit Austriak për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

